

BULETINI I SHKOLLËS

Tetor 2024



PËRSHËNDETJE TË NDERUAR PRINDËR!

Nëpërmjet kësaj letre informuese, dëshirojmë t'ju vëmë në dijeni për disa nga aktivitetet që janë zhvilluar gjatë muajve shtator dhe tetor në shkollën e mesme jopublike "Turgut Ozal". Këto aktivitete janë mundësi të shkëlqyera për zhvillimin e nxënësve tanë dhe promovimin e angazhimit të tyre në mësim, si dhe jashtë tij.



JAVA E ORIENTIMIT

Nxënësit e rinj të shkollës sonë u njohën me rregullat, oraret e aktivitetet që ofrohen, në mënyrë që të integrohen më lehtë në mjedisin e ri shkollor. Ish-maturantët ndanë përvojat e tyre me këta nxënës të klasës së 10-të, duke i motivuar për vitet e ardhshme shkollore.



TRAJNIMI PËR NDIHMËN E PARË

Stafi mori udhëzime praktike për reagimin e shpejtë në situata emergjente (arreste kardiale, mbytje, kriza epileptike etj).



PROGRAMI I KEMBRIXHIT

Nxënësit morën certifikatat e para nga Universiteti i Kembrixhit, duke vazhduar rrugëtimin drejt diplomës britanike. 8 nxënës arritën të merrnin vlerësimin më të lartë, A*.



TAKIMI ME SONILA MEÇO

Gazetarja Sonila Meço ndau përvojat dhe këshillat e saj profesionale me nxënësit.



SEMINAR PËR KANCERIN E GJIRIT

Nxënësit morën pjesë në një seminar për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e diagnostikimit të hershëm.



WORKSHOP PËR "GAME DESIGN"

Nxënësit zhvilluan ide për lojëra video me temë trashëgiminë kulturore, duke punuar nën mentorimin e ekspertëve.



EKSPERIMENTE NË FIZIKË

Nxënësit mësuan për ligjet e pasqyrit dhe përdhërjes së dritës përmes eksperimenteve praktike.



VIZITA NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

Nxënësit e senatit të shkollës vizituan Kuvendin dhe mësuan për procesin e miratimit të ligjeve.



SEMINAR ME GENTË POPËN

Gazetarja e njohur ndau përvojat e saj me nxënësit, duke i frymëzuar ata për të ndjekur karrierën në gazetari.



SEMINAR ME RUDINA XHUNGËN

Gazetarja Rudina Xhunga ndau përvojat e saj profesionale dhe jetësore me nxënësit.

TAKIMI ME LUAN RAMËN

Ish-ambasadori dhe shkrimtari Luan Rama ndau përvojat dhe vlerat e tij me nxënësit. U ndjemë krenarë për punën e nxënësit tonë, Rubin Bekteshit, i cili me vendosmëri e punë të palodhur përktheu nga frengjishtja në shqip librin e L. Ramës 'Udha e gjatë në tunelin e Platonit'.



MUAJI I ARTIT DHE LETËRSISË

Gjatë muajit tetor, nxënësit e shkollës sonë shprehën krijimtarinë e talentin e tyre në vizatim, kompozicion, këngë dhe recitim. Pas përzgjedhjes së fituesve në fazën e shkollës, nxënësit u përballën me fitues nga shkollat e tjera në fazën finale, duke marrë shumë lëvdata e medalje.

KLUBET E SHKOLLËS

Klubet janë një formë shumë e mirë e angazhimit aktiv në aktivitete interesante, e zgjerimit të njohurive dhe zhvillimit të talenteve, prandaj këtë vit shkolla jonë ka hapur plot 14 klube që përfshijnë fusha të ndryshme, si: artin, kulturën, median, teknologjinë, sportin, debatin, shkencën etj.

EKSKURSION NË ISLANDË

Nxënësit e Klubit "National Geographics" dhe ata të Klubit të Historisë vizituan destinacione të famshme të Islandës, si Parkun Kombëtar Thingvellir dhe Zonën Gjeotermale Geysir.



SEMINAR ME PAOLA DEDAJ

Ish-nxënësja Paola Dedaj ndau sfidat dhe përparësitë e studimeve në degën e mjekësisë.

AKTIVITET NË GJEOGRAFI

Nxënësit zhvilluan aftësi praktike në matjen e kohës dhe orientimin në terren.

EKSPERIMENT NË FIZIKË PËR DRITËN

Nxënësit studiojnë sjelljen e dritës nëpërmjet eksperimenteve për pasqyrimin dhe përhyerjen.

Seminar mbi Menaxhimin e Kohës

Ish-nxënësja Artela Roshi ndau strategji për menaxhimin efektiv të kohës. Seminar në klasa nga psikologët mbi këtë temë.

Trajnim i Stafit

Stafi i shkollës sonë zhvilloi disa seanca trajnimi me University of Cambridge dhe Center for School Leadership. Ne jemi të përkushtuar për të nxitur kulturën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional, duke u siguruar që nxënësit tanë të marrin arsimin më cilësor.

Hapet pusi i ujit në Afrikë

Me iniciativën e shkollës sonë e me kontributin e të gjithëve ne, u finalizua me sukses puna për hapjen e një pusi uji në një shkollë fshati afër Mombasës, në Kenia.



Medalje Ari për Sukseset Akademike

13 nxënësit tanë, që fituan medalje ari për arritjet e shkëlqyera, u nderuan për përkushtimin dhe sukseset e tyre.

Ekipi Alumni

Ekipi Alumni ka zhvilluar takime me ish-nxënësit e shkollës sonë në vendet ku ata ndodhen, si në Itali, Gjermani dhe në Shqipëri.

ZGJEDHJET E SENATIT TË SHKOLLËS

Çdo klasë zgjodhi senatorin e saj, më pas senatorët konkuruan për presidentin e shkollës. Pas zgjedhjeve, president i senatit të shkollës u shpall Raitin Kola, ndërsa zv. presidente u zgjodh Fjona Shpata.



Ne inkurajojmë të gjithë nxënësit të marrin pjesë në aktivitete të ngjashme në të ardhmen, pasi ato janë një mundësi shumë e mirë për të zhvilluar aftësi të reja dhe për të mësuar nga përvoja e njerëzve të suksesshëm.

Përkrahni dhe nxisni fëmijët tuaj të angazhohen aktivisht në këto mundësi të vlefshme!

Me respekt,
Stafi i Shkollës "Turgut Ozal"

